EKSTRAKT I JETËSHKRIMEVE TË NËPUNËSVE CIVILË TË NIVELIT TË LARTË DHE TË MESËM DREJTUES, SI DHE I FUNKSIONARËVE POLITIKË DHE TË KABINETIT NË INSTITUCIONIN E AVOKATIT TË POPULLIT

ZNJ. ETRITA PETRITI
Sekretar i Përgjithshëm

Znj.Etrita Petriti është juriste dhe drejtuese me përvojë të gjatë në administratën publike, menaxhimin e burimeve njerëzore, shërbimet administrative dhe çështjet juridike. Ajo ka përfunduar studimet në Shkenca Juridike në Universitetin Luarasi dhe studimet Master në Shkenca Juridike Civile në Fakultetin e Drejtësisë, Universiteti i Tiranës. Është pajisur me titullin "Avokat", licencë për ndërmjetësim dhe licencë si Auditues i Brendshëm në Sektorin Publik.

Ka mbajtur detyrën e Drejtorit të Departamentit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative në Këshillin e Lartë Gjyqësor, ndërsa më parë ka mbajtur pozicione drejtuese në fushën e burimeve njerëzore, rekrutimit, promovimit dhe administrimit të prokurimeve pranë të njëjtit institucion. Gjithashtu, ka një karrierë të gjatë në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, ku ka shërbyer si juriste dhe më pas në pozicione drejtuese në menaxhimin e burimeve njerëzore.

Me mbi 18 vite përvojë profesionale në sektorin publik, Etrita Petriti ka kontribuar në zhvillimin e politikave të menaxhimit të personelit, forcimin e administratës publike dhe garantimin e standardeve të qeverisjes institucionale. Ajo zotëron njohuri të avancuara të gjuhës angleze dhe është e angazhuar në aktivitete profesionale e shoqërore, duke marrë pjesë në trajnime dhe konferenca kombëtare e ndërkombëtare në fushat e së drejtës, administratës publike dhe zhvillimit institucional.

KABINETI I AVOKATIT TË POPULLIT

Kabineti i Avokatit të Popullit drejtohet nga Drejtori i Kabinetit, dhe ka në përbërje pesë këshilltarë.

Z. PETRIT BUSHI
Drejtor i Kabinetit të Avokatit të Popullit

Dr. Petrit Bushi është jurist, ekonomist dhe ekspert në fushën e administratës publike, qeverisjes institucionale, hetimeve financiare dhe luftës kundër korrupsionit, me mbi 35 vite përvojë profesionale në sistemin e drejtësisë, administratën publike, arsimin e lartë dhe menaxhimin ekzekutiv.

Ai mban gradën Doktor i Shkencave Juridike në të drejtën publike, të fituar në Universitetin Europian të Tiranës, me temë doktorature mbi hetimet financiare dhe konfiskimin e produkteve të krimit. Gjithashtu është diplomuar në Shkencat Juridike dhe në Shkencat Ekonomike (Financë) në Universitetin e Tiranës, duke ndërthurur ekspertizën juridike me atë ekonomike.

Aktualisht ushtron detyrën e Drejtorit të Kabinetit pranë Institucionit të Avokatit të Popullit.
Më parë ka drejtuar korporata në cilësinë e Chief Executive Officer (CEO), ndërsa në arsimin e lartë ka mbajtur funksionet e Zëvendës Rektorit, Drejtorit për Planifikim dhe Zhvillim, Dekanit dhe Prodekanit në Kolegjin AAB në Prishtinë, ku njëkohësisht ka zhvilluar veprimtari të gjerë si ligjërues universitar.

Karriera e tij profesionale përfshin edhe funksione drejtuese në Policinë e Shtetit dhe administratën publike shqiptare, si Shef i Sektorit Kundër Korrupsionit, Pastrimit të Parave dhe Krimit Ekonomik-Financiar, Oficer Ndërlidhës pranë Ambasadës së Republikës së Shqipërisë në Kosovë, Shef i Sektorit të Prokurimeve Publike në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, si dhe Hetues dhe Oficer i Policisë Gjyqësore pranë Prokurorisë.

Dr. Bushi ka ndjekur programe të shumta specializimi të organizuara nga Këshilli i Evropës, OSBE, OECD dhe institucione të tjera ndërkombëtare, në fushat e hetimeve financiare, konfiskimit të produkteve të krimit, luftës kundër korrupsionit, prokurimeve publike dhe bashkëpunimit juridik ndërkombëtar. Ai është autor i disa botimeve shkencore në revista ndërkombëtare dhe pjesëmarrës aktiv në konferenca akademike, me kontribut të veçantë në zhvillimin e politikave publike, qeverisjes së mirë dhe forcimit të shtetit të së drejtës.

ZNJ. DUDI ILIAS
Këshilltare e Avokatit të Popullit

Znj. Dudi Ilias është një profesioniste e re e të drejtës kushtetuese dhe administrative, me përvojë në këshillim ligjor dhe politikëbërje pranë institucioneve kushtetuese shqiptare, mekanizmave ndërkombëtarë të monitorimit të shtetit të së drejtës dhe shoqërisë civile. Ajo ushtron aktualisht detyrën e Këshilltares në Kabinetin e Avokatit të Popullit.

Përpara këtij angazhimi, znj. Ilias ka shërbyer si Këshilltare për të drejtën kushtetuese dhe administrative në Kabinetin e Kryetares së Kuvendit të Shqipërisë, si dhe më herët si specialiste e politikave antikorrupsion në Ministrinë e Drejtësisë, në Drejtorinë e Përgjithshme të Antikorrupsionit. Ajo ka ushtruar gjithashtu detyrën si eksperte e qeverisë shqiptare pranë Mekanizmit të Rishikimit të Zbatimit të Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit (UNCAC), si edhe ka qenë anëtare e delegacionit të Shqipërisë në Grupin e Shteteve kundër Korrupsionit (GRECO) të Këshillit të Evropës.

Përtej angazhimit institucional, znj. Ilias kontribuon si eksperte vendase për Shqipërinë në "Indeksin e Sundimit të Ligjit" të Projektit të Drejtësisë Globale (WJP) dhe në serinë e raporteve të Bankës Botërore "Gratë, Biznesi dhe e Drejta". Njëkohësisht, ajo ka dhënë një kontribut të rëndësishëm në fushën e transparencës dhe edukimit ligjor në Shqipëri përmes themelimit të platformës "Open Akte", nismë e cila ka ndërlidhur mbi 700 akte ligjore dhe nënligjore me relacionet e tyre shpjeguese, duke i shërbyer informimit të mbi 15 mijë përdoruesve të platformës.

Znj. Ilias ka një angazhim të rregullt në formimin praktik të studentëve të rinj të drejtësisë, duke shërbyer si anëtare e paneleve të vlerësimit në konkurse ndërkombëtare të simulimit gjyqësor. Në këtë kuadër, ajo ka shërbyer në juritë ndërkombëtare dhe ato kombëtare të Belgjikës, Holandës, Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Afrikës së Jugut dhe Federatës Ruse për konkursin Philip C. Jessup International Law Moot Court Competition, si edhe në panelin ndërkombëtar të vlerësimit të International Criminal Court Moot Court Competition, të organizuara përkatësisht nga Organizata Ndërkombëtare e Studentëve të Drejtësisë (ILSA) dhe Qendra Grotius për Studime Ligjore Ndërkombëtare.

Profili profesional i znj. Ilias mbështetet gjithashtu edhe nga formimi i saj akademik. Ajo është diplomuar me një Master të Shkencave në Drejtësi nga Universiteti i Pensilvanisë, në Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe një Master të Arteve në Marrëdhënie Ndërkombëtare nga Universiteti Queen Mary i Londrës, në Mbretërinë e Bashkuar.

ZNJ. LUVEDA DARDHA
Këshilltare e Avokatit të Popullit

Znj. Luveda Dardha është juriste në profesion, me njohuri të spikatura dhe të thelluara në fusha të ndryshme të së drejtës, në të drejtën e brendshme dhe atë ndërkombëtare, në veçanti në fushën e të drejtave të njeriut. Ajo ka përfunduar studimet universitare në Fakultetin e Drejtësisë, Universiteti i Tiranës në vitin 2008, diplomuar me titullin " Jurist", për të vijuar me pas, në vitin 2009 duke marrë edhe titullin " Avokat", nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë. Në vitin 2013 përfundoi studimet në Shkollën e Magjistraturës, ku u diplomua me titullin " magjistrat", profili gjyqtare. Aktualisht ushtron detyrën e Këshilltares në Kabinetin e Avokatit të Popullit.

Përpara angazhimit në këtë institucion, ajo ka dhënë kontributin e saj në sistemin gjyqësor, ku gjatë karrierës së saj profesionale ka ushtruar detyrën e gjyqtares në fusha të ndryshme të së drejtës, me një angazhim dhe përvojë të veçantë në fushën e drejtësisë penale dhe drejtësisë penale për të mitur. Në këtë kuadër ka trajtuar çështje që lidhen me mbrojtjen e të drejtave dhe interesit më të lartë të fëmijës në procesin penal, si viktimë, dëshmitar, apo i mitur në konflikt me ligjin, duke qenë e angazhuar në vijimësi për të garantuar zbatueshmërinë e standardeve europiane nëpërmjet implementimit edhe të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur.

Eksperienca e saj profesionale përfshin gjithashtu pjesëmarrje në mënyrë të vazhdueshme në programe trajnimi dhe aktivitete të ndryshme profesionale, brenda dhe jashtë vendit, të organizuara Shkolla e Magjistraturës, në bashkëpunim dhe me organizata ndërkombëtare, edhe si trajnuese në fushën e drejtësisë penale për të mitur, drejtësinë restauruese, ndryshimet e Kodit të Procedurës Penale në kuadër të reformës në drejtësi, si dhe në çështje që lidhen me institute të së drejtës penale dhe procedurale penale. Zotëron njohuri dhe ekspertizë të konsoliduar në fushën e të drejtave të njeriut, me fokus të veçantë në garantimin e të drejtës për një proces të rregullt ligjor, veçanërisht në çështjet penale dhe në zbatimin dhe interpretimin e standardeve të përcaktuara nga Konventa Europiane dhe jurisprudenca e Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut, jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykata e Lartë në Republikën e Shqipërisë.

Kontributi i saj në fushën e drejtësisë është realizuar edhe nëpërmjet ushtrimit të profesionit të Avokatit, në mbrojtjen dhe përfaqësimin e çështjeve të ndryshme familjare, civile, administrative dhe tregtare, duke ofruar përfaqësim profesional dhe duke ndjekur procese dhe procedura gjyqësore në gjykata të ndryshme. Zotëron njohuri shumë të mira në gjuhën angleze dhe italiane, në veçanti anglishten ligjore, si dhe është autore e disa publikimeve të botuara në revistën Jeta Juridike në Shkollën e Magjistraturës, që lidhen me analizën e instituteve të ndryshme në të drejtën procedurale penale.

ZNJ. AURORA BALLIU
Këshilltare e Avokatit të Popullit

Znj. Aurora Balliu është eksperte në fushën e arsimit, vlerësimit dhe drejtimit institucional, me profil të konsoliduar akademik dhe përvojë të gjerë profesionale. Formimi i saj akademik përfshin studimet e larta në Fakultetin e Histori-Filologjisë, dega Gjuhë-Letërsi, pranë Universitetit të Tiranës; studimet në Fakultetin e Drejtësisë, dega Drejtësi, pranë Universitetit të Tiranës; Masterin Shkencor në Studime Letrare pranë Shkollës Doktorale të Qendrës së Studimeve Albanologjike, si dhe Masterin Shkencor në të Drejtë Penale pranë Fakultetit të Drejtësisë.

Karriera e saj është ndërtuar mbi një angazhim të gjatë dhe të qëndrueshëm në fushën e arsimit, duke përfshirë mësimdhënien, drejtimin dhe administrimin arsimor, menaxhimin institucional, si edhe përvojën akademike si lektore. Në detyrën e Drejtores së Përgjithshme të Qendrës së Shërbimeve Arsimore, ajo ka udhëhequr procese

të rëndësishme në administrimin e shërbimeve arsimore dhe në organizimin e vlerësimeve kombëtare dhe ndërkombëtare.

Pjesëmarrja në programe dhe trajnime kombëtare dhe ndërkombëtare dëshmon angazhimin e saj të vazhdueshëm në zhvillimin profesional dhe përafrimin me standardet bashkëkohore të arsimit dhe vlerësimit. Ajo ka përfaqësuar Shqipërinë në PIRLS 2021/2026 NRC Meeting, organizuar nga IEA Amsterdam; në takimin Shifting Balance, Changing Models, pranë ENIC UK në Londër; si dhe në PISA 2025 NPM Meeting, organizuar nga OECD në Lisbonë. Gjithashtu, ajo ka ndjekur programin e avancuar Item Response Theory and Population Modeling in Large Scale Assessments, organizuar nga ETS në New Jersey, SHBA.

Ka qenë pjesë e grupit të punës në takimet Screening: Bilateral Meeting – Chapter 26: Education and Culture pranë Bashkimit Europian në Bruksel.

Me vizion profesional, përvojë të konsoliduar dhe angazhim të vazhdueshëm, Aurora Balliu ka luajtur një rol të rëndësishëm në forcimin e standardeve të arsimit, në hartimin e politikave arsimore dhe në ndërtimin e një sistemi më cilësor, gjithëpërfshirës dhe të orientuar drejt zhvillimit të qëndrueshëm institucional.

ZNJ. ESIONA KONOMI
Këshilltare e Avokatit të Popullit për marrëdhëniet me median

Znj. Esiona Konomi është një eksperte në fushën e komunikimit dhe kërkimit mbi median në Shqipëri, me një përvojë mbi dhjetëvjeçare në mbulimin e zhvillimeve institucionale dhe proceseve integruese të vendit si gazetare politike.

Ajo ka kryer studimet e larta pranë Universitetit të Tiranës, ku mban një diplomë Bachelor në Gazetari dhe Komunikim si dhe një Master Shkencor në Marrëdhënie Publike. Përgatitja e saj akademike është pasuruar me kualifikime të rëndësishme ndërkombëtare, duke qenë alumne e Programit IVLP të Departamentit Amerikan të Shtetit, e certifikuar nga Akademia e Studimeve Politike (Këshilli i Evropës), si dhe e trajnuar për gazetarinë e të dhënave në Estoni.

Gjatë karrierës së saj, Znj. Konomi ka punuar si gazetare politike në mediat kryesore në vend (përfshirë Report TV, ABC News dhe Shqiptarja.com), duke raportuar mbi aktivitetet e Parlamentit, Qeverisë dhe KQZ-së, si dhe ka angazhuar si lektore në Universitetin “Aleksandër Moisiu”.

Në kuadër të kualifikimeve menaxheriale dhe angazhimit publik, ajo është bashkëthemeluese dhe anëtare bordi e Asociacionit të Gazetarëve të Shqipërisë (AGSH). Gjithashtu, ajo ka drejtuar nisma si projekti "Dalloje Rrenën" dhe ka shërbyer si eksperte kërkimore e konsulente për çështjet e medias, dezinformimit dhe komunikimit për organizata prestigjoze si OSBE, Këshilli i Evropës, Ambasada e SHBA-së dhe Ambasada Britanike.

SEKSIONI PËR MBROJTJEN DHE PROMOVIMIN E TË DREJTAVE TË FËMIJËVE

Seksioni për Mbrojtjen dhe Promovimin e të drejtave të Fëmijëve drejtohet nga Komisioneri dhe ka në përbërje tre ndihmëskomisionerë të cilët janë nëpunës civilë.

Komisioneri për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve është zgjedhur nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë në përputhje me procedurat e parashikuara në nenin 33/1 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999, "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar.

ZNJ. ALMA FASKAJ
Komisionere e Seksionit për Mbrojtjen dhe Promovimin e të drejtave të Fëmijëve

Znj. Alma Hakik Faskaj (Vokopola) është juriste shqiptare me profil të spikatur në të drejtën publike, administrative dhe të drejtat e njeriut, e lindur më 21 gusht 1973, me banim në Tiranë. Aktualisht mban detyrën e Komisioneres për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Njeriut, ku është emëruar më 8 maj 2026.

Është diplomuar "Juriste" me medalje ari në Fakultetin e Drejtësisë (1991–1995) dhe ka thelluar formimin akademik me studime "Master" në Drejtësi (2001–2006, me temë mbi procedimin administrativ sipas Kodit të Procedurave Administrative) dhe me doktoraturë në të Drejtën Publike (2010–2014).

Karriera e saj profesionale nis si gjyqtare në Gjykatën e Shkallës së Parë Lushnjë (1995–1996) dhe si nënkryetare e Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave për ish-pronarët në Lushnjë (1996–1998). Më pas ka shërbyer për mbi një dekadë pranë Institucionit të Avokatit të Popullit — fillimisht si ndihmëskomisionere (2000–2001) dhe më tej si këshilltare ligjore në Kabinetin e Avokatit të Popullit (2001–2011). Nga viti 2014 ka punuar si këshilltare në Drejtorinë e Përafrimit të Legjislacionit pranë Kuvendit të Shqipërisë. Në vitet 2017–2024 ka qenë anëtare e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, organi që zhvilloi procesin e vetingut (rivlerësimit kalimtar) të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Shqipëri. Ushtron detyrën e Komisioneres për Mbrotjen dhe promovimin e të drejtave të fëmijëve prej datës 8 Qershor 2026.

Paralelisht me karrierën institucionale, ka zhvilluar një veprimtari të gjerë akademike si pedagoge e jashtme e së Drejtës Administrative si lektore pranë Shkollës së Magjistraturës si dhe në disa universitete jopublike. Është angazhuar gjithashtu si eksperte në projektin "Reforma në Drejtësi" dhe si eksperte e UNICEF-it për hartimin e Kodit të Drejtësisë për të Mitur.

E specializuar në të drejtat e njeriut dhe mirëadministrimin publik, ka një portofol të pasur botimesh, studimesh e referimesh në konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare (përfshirë OSBE-në, Këshillin e Evropës dhe universitete italiane). Zotëron anglisht dhe italisht shumë mirë, ndërsa frëngjisht në nivel shkëlqyes.

ZNJ. ANILA NEPRAVISHTA
Ndihmëskomisionere në Seksionin për Mbrojtjen dhe Promovimin e të drejtave të Fëmijëve

Znj. Anila Nepravishta është pjesë e insitucionit të Avokatit të Popullit prej vitit 2000. Aktualisht, mban pozicionin Ndihmëskomisionere në Seksionin për Mbrojtjen dhe Promovimin e të drejtave të Fëmijëve., me statusin e nëpunësit civil të nivelit të lartë drejtues. Ajo ka përfunduar studimet në Fakultetin Juridik të Universitetit të Tiranës.

Pas kryerjes së studimeve universitare në vitet 1990-1994 dhe diplomimit në vitin 1994 "Juriste" në Universitetin e Tiranës , në periudhën e viteve 2003-2005 është diplomuar "Master" në Shkollën Pasuniversitare për Studime Evropiane, Tiranë. Po ashtu, në vitet 2010-2013 ka fituar titullin "Doktor", në Fakultetin e Drejtësisë, Universiteti i Tiranës. Ka punuar pas diplomimit, si as.pedagoge në Fakultetin Juridik, Universiteti "Luigj Gurakuqi", Shkodër, lektore në periudhën e viteve 1994-1997 në lëndën " E drejta administrative", dhe ka qenë Shefe e Departamentit të së Drejtës Publike. Ndërsa në periudhën e viteve 1997-2000 ka punuar Juriste, në Kontrollin e Lartë të Shtetit, Tiranë. Me krijimin e institucionit të Avokatit të Popullit në vitin 2000, ka filluar punë në këtë institucion dhe vijon të punojë pranë këtij institucioni kombëtar të mbrojtjes së të drejtave të njeriut. Në periudhën e viteve 2000-2010 ka punuar ndihmëskomisionere në Seksionin e Përgjithshëm; Për periudhën 2010-2013 është zgjedhur nga Kuvendi i Shqipërisë për Komisionere për Seksionin e Përgjithshëm. Aktualisht ajo vijon punën pranë këtij institucioni si ndihmëkomisionere në Seksionin për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve. Znj. Nepravishta është specializuar nga Shkolla Shqiptare e Administratës Publike është si trajnere në fushën e Antikorrupsionit.

ZNJ. MATILDA TYLI
Ndihmëskomisionere në Seksionin për Mbrojtjen dhe Promovimin e të drejtave të Fëmijëve

Znj. Matilda Tyli është pjesë e insitucionit të Avokatit të Popullit prej vitit 2016. Aktualisht, mban pozicionin Ndihmëskomisionere në Seksionin për Mbrojtjen dhe Promovimin e të drejtave të Fëmijëve, me statusin e

nëpunësit civil të nivelit të lartë drejtues. Ajo ka përfunduar studimet në Fakultetin e Shkencave Sociale të Universitetit të Tiranës në vitin 1999, duke u diplomuar për Punë Sociale. Gjatë periudhës së studimeve dhe me pas, ka qënë e angazhuar në shoqërinë civile duke luajtur një rol aktiv në fuqizimin e organizatave jo-qeveritare rinore në drejtim të mbrojtjes së të drejtave të grupeve të marxhinalizuara si përdoruesit e drogës, fëmijët në nevojë, viktimat e trafikimit. Në prill të vitit 1999, filloi punë në Organizatën Ndërkombëtare "Christian Children Found" (ÇF) ku u trajnua për eleminimin e Stresit Post Traumatik dhe Traumat e Luftës nga ekspertë dhe profesor të Universitetit të Texasit-USA me qëllim lehtësimin e pasojave traumatike të fëmijëve si rezultat i luftës së Kosovës. Në periudhën 2010-2012, ka përfunduar Masterin e Nivelit të Dytë në Institutin e Studimeve Evropiane të Universitetit të Tiranës dhe tema e mbrojtur në fund të këtij cikli studimesh është "Kujdesi social për fëmijët në nevojë". Në periudhën 2000-2016, ajo punoi pranë institucioneve të administratës publike në nivel zbatues dhe hartues politikash, konkretisht në Ministrinë e Kulturës Rinisë dhe Sporteve, Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror, Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë në të cilën kontributi i saj ka konsistuar në hartimin e shumë akteve ligjore dhe nënligjore në drejtim të mbrojtjes sociale me qëllim sigurimin dhe ofrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror, për të garantuar mirëqenie dhe përfshirje shoqërore të individëve e të familjeve që kanë nevojë për kujdes shoqëror. Paralelisht me detyrat e mësipërme znj.Tyli ka dhënë ndihmesën e saj edhe në hartimin e legjislacionit shqiptar, ku disa nga kontributet më të spikaturat kanë qenë: anëtare e Grupit të Punës për hartimin e ligjit nr. 163/2014 "Për Urdhrin e Punonjësve Social në Republikën e Shqipërisë", ligjit nr. 40/2016 "Për Urdhrin e psikologut në Republikën e Shqipërisë". Gjatë eksperiencës së punës në aministratën publike, përgjegjesitë e niveleve të ndryshme që ka patur, i kanë dhënë znj.Tyli mundësinë që të zhvilloj aftesitë profesionale, paralelisht me kërkesat e reja të zhvillimeve shoqërore për përballimin e sfidave të reja në drejtim të zhvillimit të demokracisë dhe mbrojtjes së të drejtave të njeriut. Në vitin 2016, znj. Matilda Tyli është emëruar ndihmëskomisioner pranë Seksionit për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve të institucionit të Avokatit të Popullit të Republikës së Shqipërisë.

Z. DONALD FETAH
Ndihmëskomisioner në Seksionin për Mbrojtjen dhe Promovimin e të drejtave të Fëmijëve

Z. Donald Fetah është pjesë e insitucionit të Avokatit të Popullit prej vitit 2019. Aktualisht, mban pozicionin Ndihmëskomisioner në Seksionin për Mbrojtjen dhe Promovimin e të drejtave të Fëmijëve. Ai ka ndjekur studimet universitare bachelor pranë Universitetit të Tiranës, Fakulteti i Shkencave Sociale, dega Shkenca Politike përgjatë viteve 2006-2009. Në vitin 2011 përfundoi studimet master shkencor në Teori Politike, me rezultate të shkëlqyera. Në periudhën 2013-2019 ka mbajtur pozicionin e Përgjegjësit të Sektorit të Shërbimit Social, në Njësinë Administrative nr.3, Bashkia Tiranë, duke kontribuar thelbësisht në përmirësimin e cilësisë së jetesës së grupeve në nevojë. Përgjatë viteve
2015-2016, ka ndjekur studimet master në Analizë të Politikave Sociale, pranë Universitetit të Tiranës, Fakulteti i Shkencave Sociale, dega Punë Sociale. Në vitin 2019 është emëruar Ndihmëskomisioner në Seksionin e Mbrojtjes dhe Promovimit të të Drejtave të Fëmijëve, në institucionin e Avokatit të Popullit.

ZNJ. ARDA HOXHA
Ndihmëskomisionere në Seksionin për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve.

Znj. Arda Hoxha (Lazareni) është eksperte në fushën e të drejtave të fëmijëve dhe politikave sociale, me mbi 20 vite përvojë profesionale në nivel qendror në hartimin, zbatimin dhe monitorimin e legjislacionit, strategjive dhe mekanizmave institucionalë të mbrojtjes së të drejtave të fëmijës në Shqipëri. Ajo mban titullin "Master i Shkencave në Zhvillimin dhe Edukimin e Fëmijëve", nga Universiteti Hacettepe, Ankara, Turqi. Për më shumë se një dekadë ka drejtuar sektorin përgjegjës për monitorimin e të drejtave të fëmijëve në Agjencinë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës, ku ka luajtur një rol kyç në monitorimin dhe kontrollin e cilësisë së punës së strukturave të mbrojtjes së fëmijës në 61 bashkitë e vendit, si dhe në ofrimin e mbështetjes teknike profesionale në raste komplekse, emergjente dhe ndërkufitare, përfshirë ato të fëmijëve në situatë trafikimi dhe migrimi. Ajo ka dhënë një kontribut të rëndësishëm në hartimin dhe zhvillimin e kuadrit ligjor dhe dokumenteve strategjikë kombëtarë për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës, si dhe ka qenë pjesë e grupeve ndërinstitucionale dhe teknike të punës në procesin e integrimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian. Gjithashtu, ka zhvilluar bashkëpunim të vazhdueshëm me organizata dhe partnerë ndërkombëtarë, si OSBE, UNICEF dhe organizata të tjera që veprojnë në fushën e mbrojtjes së fëmijës. Prej qershorit 2025, është bashkuar me Institucionin e Avokatit të Popullit, ku ushtron detyrën e Ndihmëskomisioneres në Seksionin për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve.

SEKSIONI PËR ORGANET E ADMINISTRATËS QENDRORE, TË PUSHTETIT VENDOR DHE TË TË TRETËVE QË VEPROJNË PËR LLOGARI TË TYRE

Seksioni i Administratës drejtohet nga Komisioneri dhe ka në përbërje gjashtë ndihmëskomisionerë të cilët janë nëpunës civilë.

Komisioneri i Seksionit të Administratës është zgjedhur nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë në përputhje me procedurat e parashikuara në nenin 33/1 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999, "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar.

ZNJ. ERINDA MELI
Komisionere e Seksionit të Administratës

Znj.Erinda Meli ushtron për një mandat 4-vjeçar funksionin e Komisioneres në Seksionin për Organet e Administratës Qendrore, të Pushtetit Vendor dhe të të tretëve që veprojnë për llogari të tyre në institucionin Avokatit të Popullit, sipas Vendimit nr. 30/2024, miratuar më datë 04.04.2024 nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë Në datën 4 prill 2024, znj. Erinda Meli është zgjedhur nga Kuvendi i Shqipërisë në pozicionin e Komisioneres në Seksionin për organet e administratës qendrore, të pushtetit vendor dhe të të tretëve që veprojnë për llogari të tyre. Ajo ka ndjekur studimet për jurisprudencë në Fakultetin e Drejtësisë në Universitetin e Tiranës ku është diplomuar në vitin 2008. Më pas ka vazhduar studimet pasuniversitare dhe në vitin 2011 ka marrë titullin "Master" në po të njëjtin universitet. Gjatë viteve 2008-2013 ka ushtruar profesionin e avokates në zyrën ligjore Haxhia dhe Hajdari në Tiranë. Në periudhën 2014-2017 për katër vite ka punuar si këshilltare ligjore në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut në Strasbourg, Francë dhe në vitin 2021 edhe si këshilltare ligjore në Gjykatën Kushtetuese. Në periudhën 2018-2024 ka punuar si avokate shteti në Avokaturën e Shtetit në nivel qendror. Znj. Meli ka qenë e angazhuar si eksperte ligjore në Këshillin e Evropës, Strasbourg, dhe organizata të tjera. Gjithashtu, ajo është e angazhuar si lektore në trajnimin fillestar në Shkollën Kombëtare të Avokatisë dhe pranë Shkollës së Magjistraturës, në programin e formimit vazhdues të gjyqtarëve dhe prokurorëve. Ajo ka qenë autore e disa punimeve akademike kryesisht me fokus të drejtat e njeriut. Zotëron gjuhët anglisht, italisht dhe frëngjisht.

Z. ARBEN GJOLEKA
Ndihmëskomisioner në Seksionin e Administratës

Z.Arben Gjoleka është pjesë e institucionit të Avokatit të Popullit prej vitit 2008. Aktualisht, mban pozicionin Ndihmëskomisioner në Seksionin e Administratës, me statusin e nëpunësit civil të nivelit të lartë drejtues. Ai ka përfunduar studimet në Fakultetin Gjeologji Miniera të Tiranës, në Degën Gjeologji- nafte në vitin 1991, duke u diplomuar me titullin inxhinier gjeolog-nafte. Pas diplomimit, filloi punë në Ndërmarrjen e Nxjerrjes së Naftës Sheqisht, Fier. Periudha e punës pranë kësaj Ndërmarrje 1991-1993. Në vitin 1994 ka përfunduar studimet në Fakultetin Juridik të Universitetit të Tiranës. Në vitin 2003 ka fituar titullin "Avokat". Në vitin 2010, është diplomuar "Master i nivelit të dytë" në Universitetin "Marin Barleti". Pas diplomimit, në periudhën 1994-2003, ka ushtruar detyrën e përmbaruesit gjyqësor, Kryetarit të Zyrës së Përmbarimit, Fier, përmbaruesit gjyqësor pranë Zyrës së Përmbarimit Tiranë, inspektorit dhe Shefit të Organizimit në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit të Përmbarimit Gjyqësor Shtetëror, pranë Ministrisë së Drejtësisë. Në periudhën 2003-2008, ka ushtruar detyrën e inspektorit, Drejtorit Judidik pranë Sh.a. Aeroport "Nënë Tereza", Tiranë, dhe juristit pranë kësaj Shoqërie në likuidim e sipër. Në vitin 2011 ka fituar titullin "Përmbarues gjyqësor privat". Prej vitit 2008 ushtron detyrën e ndihmëskomisionerit pranë "Seksionit për organet e administratës qendrore, të pushtetit vendor dhe të të tretëve që veprojnë për llogari të tyre". Në detyrën e ndihmëskomisionerit ka dhënë ndihmesën në evidentimin

e papajtueshmërisë së projekt-ligjve, ligjeve, akteve nënligjore, me Kushtetutën apo ligje të tjera të veçanta, duke përgatitur me këtë rast kërkesa drejtuar Gjykatës Kushtetuese, e përfaqësuar Institucionin e Avokatit të Popullit në këtë Gjykatë, si dhe, përgatitur rekomandime të natyrës legjislative apo rekomandime për rivendosjen në vend të një të drejte, lirie apo interesi të ligjshëm të individit prej organeve të administratës publike.

Z. ENIO HAXHIMIHALI
Ndihmëskomisioner në Seksionin e Administratës

Z.Enio Haxhimihali është pjesë e institucionit të Avokatit të Popullit prej vitit 2014. Ai ka lindur ne Tiranë në vitin 1972. Pas përfundimit të studimeve në Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit të Tiranës në vitin 1995, ka punuar kryesisht në institucionet kryesore të Drejtësisë dhe jo vetëm. Ai e ka nisur karrierën si ndihmësgjyqtar në Gjykatën e Rrethit Tiranë, më pas ka vazhduar në Drejtorinë e Përgjithshme të Kodifikimit, pranë Ministrisë se Drejtësisë; me krijimin e Gjykatës së Krimeve të Rënda ai ka qenë kancelari i parë i kësaj gjykate; ka dhënë kontributin në Drejtorinë e Studimeve dhe Kërkimeve Ligjore pranë Prokurorisë së Përgjithshme; pas fitimit te konkursit për Avokat Shteti ka dhënë kontributin në zyrën qendrore të Avokaturës së Përgjithshme të Shtetit, etj. Z. Haxhimihali ka një përvojë të admirueshme edhe në kabinetet e ekzekutivit, apo edhe të institucioneve të pavarura. Fillimisht ai ka qenë këshilltar ligjor i Ministrit të Kulturës, detyrë të cilën e ka ushtruar edhe me ministrin pasardhës; ai ka qenë për disa vite në detyrën e drejtorit të Kabinetit të Ministrit të Brendshëm; për disa vite në funksionin e drejtorit të Kabinetit në Autoritetin e Mediave Audiovizive (fillimisht ish Këshilli Kombëtar i Radiotelevizionit) dhe që nga viti 2014 si drejtor i Kabinetit në institucionin kushtetues të Avokatit të Popullit, detyrë të cilën vazhdon ta ushtrojë edhe aktualisht me Avokatin pasardhës. Vlen për tu përmendur që kontributi i tij në Kabinetet e institucioneve të ekzekutivit, falë punës së tij thellësisht teknik, ka bërë që ai të jetë pjese e kabineteve të forcave të ndryshme politike, pa qenë pjesë e asnjë partie. Ai paralelisht me detyrat e mësipërme, për disa vite akademike, ka dhënë kontributin e tij edhe si Pedagog i jashtëm në: Shkollën Shqiptare të Magjistraturës; Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit shtetëror të Tiranës (ku futi për herë të parë në Universitetet shqiptare një lëndë të re) dhe në Universitetin privat "Albanian University". Vlen për tu theksuar se në institucionet e mësipërme, ai ka qenë jo vetëm lektor, por edhe hartuesi i ciklit të leksioneve përkatëse. Për sa i përket formimit te tij, ai ka kryer studimet e mesme në gjimnazin e përgjithshëm "Sami Frashëri" në Tiranë, studimet e larta në Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit të Tiranës dhe pas fitimit të një burse nga Ambasada Franceze në Tiranë, ka ndjekur studimet e thelluara pasuniversitare në Universitetin e Sorbonës, Paris – Francë. Gjithashtu, ai ka ndjekur edhe mjaft trajnime, brenda e jashtë vendit, ku veçohen: Shkolla Shqiptare e Studimeve Politike (organizuar nga Këshilli i Evropës); kursi i trajnimit: "Drejtësia dhe Policia për vendimmarrësit e niveleve të larta në vendet e Ballkanit Perëndimor", organizuar në: Angli, Francë, Gjermani dhe Hungari, nga: Komisioni Europian, Kolegji Policor Europian (CEPOL) dhe Shoqata Evropiane e Kolegjeve të Policisë (AEPC); kursi i trajnimit: "Për personat që mbulojnë marrëdhëniet me publikun", organizuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim dhe Instituti Shqiptar i Mediave; kursi i trajnimit: "Procesi i kodifikimit të legjislacionit francez", Paris – France, organizuar nga Ambasada Franceze në Tiranë dhe zhvilluar pranë institucioneve franceze: Komisioni i Lartë i Kodifikimit, Senat, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Brendshme, Ministria e Mbrojtjes dhe drejtoria e botimit të Gazetës Zyrtare; kursi i trajnimit: "Mbrojtja e të Drejtave të Njeriut", Paris – Francë, organizuar nga Shkolla Franceze e Magjistraturës, në bashkëpunim me Këshillin e Evropës, etj. Gjatë karrierës së tij ai ka qenë përfaqësues në institucione të rëndësishme, brenda e jashtë vendit ku veçohen: Ekspert dhe përfaqësues i shtetit Shqiptar pranë Këshillit të Evropës në Komisionin e Luftës Kundër Pastrimit të Parave (CDPC: European Committee on Crime Problems; PC-R-EV: Select Committee of Experts on the Evaluation of Anti-Money-Laundering Measures (MONEYVAL), Strasburg – Francë; Përfaqësues i Shtetit Shqiptar ne Gjykatën Ad Hoc "Për gjykimin e dëmeve te shkaktuara nga trupat e KFOR ne Shqipëri"; Anëtar i

Komisionit të Lartë të Apelimit të Tatim Taksave, organ i pavarur pranë Ministrisë Shqiptare të Financave (si përfaqësues i Ministrisë se Drejtësisë), anëtar i Bordit të Etikës në Këshillin Shqiptar të Medias, etj. Njëkohësisht z. Haxhimihali ka marrë pjesë në dhjetëra studime, ka mbajtur kumtesa e referate brenda e jashtë vendit, si dhe ka qenë pjesëmarrës në shumë projekte të ndryshme ligjore, ku do të veçonim: ekspertizën ligjore si ekspert i pavarur në projektin "Përafrimi i legjislacionit mjedisor shqiptar me atë të B. E.-së", financuar nga Komisioni Europian (Europe Aid/118904/C/SV/AL); Projektin: "Forcimi i rolit te gjyqesorit ne mbrojtje te lirise se shprehjes", financuar nga Komisioni Europian (Europe Aid/133945/L/ACT/AL); Ekspert ligjor dhe hartues i raportit për vlerësimin e zbatimit të Direktivave te Këshillit të Evropës dhe Rekomandimeve të Kuvendit Europian në lidhje me zbatimin e kritereve nga Inspektorët në Shtetet Anëtare, projekt i financuar nga Bashkimi Europian (kontraktuar nga Regional Environmental Center), apo i kontraktuar drejtpërdrejt si ekspert ligjor i pavarur në disa projekte të Bankës Botërore, UNDP, ORT-ja amerikane, programi "Rrjeti i demokracisë në Shqipëri"; apo edhe projekte të financuara nga
UNEP (United Nations Environment Program); GEF (Global Environment Facility), KfË (Kreditanstal fur Ëisenschaft); Sëedish International Development Agency, IDA (International Development Fund); GTZ (Gesellschaft fur Technische Zusammenarbeit - Shoqëria Gjermane për bashkëpunimin teknik); Regional Environmental Center, for Central and Eastern Europe; Milieukontakt Oost-Europa, etj. Gjithashtu z. Haxhimihali ka një karrierë edhe si aktivist i shoqërisë civile, që nis në vitin 1993, si bashkëthemelues dhe anëtar i Bordit Drejtues të organizatës së parë joqeveritare studentore për mbrojtjen e mjedisit "Perla"; më pas ka qenë themelues dhe drejtues i organizatës jofitimprurëse "Juristët Shqiptarë për Mbrojtjen e Mjedisit", anëtar i Shoqatës joqeveritare franceze të juristëve të së Drejtës Mjedisore (AJDE), apo edhe anëtar i Bordit Drejtues të shoqatës joqeveritare "Dajti AlpinoTuristike". Ndër aktivitetet e shumta që ka kryer, veçohet kontributi disavjeçar, si trajner për trajnimin e organizatave jofitimprurëse shqiptare, në fushën e pjesëmarrjes publike.

ZNJ. ELISA MJEKRA
Ndihmëskomisionere në Seksionin e Administratës

Znj. Elisa Mjekra është pjesë e institucionit të Avokatit të Popullit prej vitit 2019. Aktualisht, mban pozicionin Ndihmëskomisionere në Seksionin e Administratës. Ajo ka përfunduar studimet Master në Fakultetin Ekonomik Aristotel dhe Fakultetin Ushtarak SSAS në Selanik, Greqi në fillim të vitit 2009. Pas diplomimit, ka punuar në një Universitet Privat. Më pas është emëruar pergjegjëse në një kompani Greko-Franceze. Në vitin 2011, pas përfundimit të studimeve një vjeçare si "Audituese e Brendshme" është emëruar inspektore Auditi pranë Ministrisë së Brendshme, ku ka punuar deri në vitin 2019.

Z. ALKET JAUPI
Ndihmëskomisioner në Seksionin e Administratës

Z. Alket Jaupi është pjesë e institucionit të Avokatit të Popullit prej vitit 2000. Aktualisht mban pozicionin Ndihmëskomisioner në Seksionin e Administratës, me statusin e nëpunësit civil të nivelit të lartë drejtues. Ai ka përfunduar studimet në Fakultetin Juridik të Universitetit të Tiranës, në vitin 1995. Në vitin 2018, ka fituar gradën shkencore "Doktor", në fushën e sigurisë dhe të të drejtave të njeriut, në Akademinë Ushtarake, Tiranë. Pas diplomimit ai ka punuar në profesionin e juristit në disa subjekte private, si dhe në shoqëri tregtare me kapital shtetëror, duke ushtruar njëkohësisht për disa kohë edhe profesionin e avokatit. Paralelisht ai ka qënë pedagog i jashtëm në Fakultetin Juridik të Universitetit të Tiranës dhe në disa universitete jopublike, si dhe vazhdon të jetë pedagog i jashtëm (lektor), në Kolegjin Universitar të Biznesit. Paralelisht me detyrën, ai ka dhënë kontributin e tij në hartimin e legjislacionit shqiptar, si pjesëmarrës në projekte të USAID dhe Fondacionit "Soros", për të drejtën

e informimit, kodin e procedurave administrative, si dhe të drejtat e minoriteteve. Në periudhën 2002-2003, ai ka qënë anëtar i Komitetit Teknik, për Institucionet e Sektorit të Drejtësisë, i ngritur nga bashkëpunimi i vendit tonë me Programin Danez të Ndihmës në Tranzicion. Ai është çertifikuar nga ASPA në vitin 2016, si trainer i administratës publike. Së fundmi, z. Jaupi është çertifikuar si pjesëmarrës i në Programin e Lidershipit të Vizitorit Ndërkombëtar "Zhvillimi i të Drejtave të Minoriteteve", zhvilluar në vitin 2018, në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

ZNJ. JONIDA VILA
Ndihmëskomisionere në Seksionin e Administratës

Znj. Jonida Vila mban pozicionin e ndihmëskomisionere në Seksionin për organet e administratës qendrore, të pushtetit vendor dhe të të tretëve që veprojnë për llogari të tyre, që prej vitit 2022. Në vitin 2012 ka mbaruar studimet të nivelit bachelor dhe master shkencor në Universitetin Luarasi për drejtësi. Ka studiuar në Universitetin në Pisa- Itali, në fakultetin e shkencave politike në profilin/degën për Ekonominë e tregut dhe administratës publike.

Z. LIRIDON PULA
Ndihmëskomisioner në Seksionin e Administratës,

Z.Liridon Pula është jurist dhe profesionist me përvojë të gjerë në administratën publike, drejtimin institucional, menaxhimin, çështjet juridike dhe administrative, si dhe administrimin dhe regjistrimin e pasurive të paluajtshme.

Formimi i tij akademik është multidisiplinar, duke ndërthurur shkencat sociale me drejtësinë. Ai ka përfunduar studimet në Filozofi–Sociologji dhe Jurisprudencë, si dhe Masterin Shkencor në të Drejtën Publike. Formimi akademik është plotësuar me studime të avancuara në nivel doktorature në Shkencat Sociale dhe kualifikime profesionale në fushën e vlerësimit dhe administrimit të pasurive të paluajtshme.

Një pjesë e rëndësishme e karrierës së tij është zhvilluar në sistemin e regjistrimit dhe administrimit të pasurive të paluajtshme. Në ish-Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZRPP) ka ushtruar funksionet e Përgjegjësit të Sektorit Tekniko-Ligjor dhe Përgjegjësit të Sektorit të Apelimit, duke fituar përvojë të drejtpërdrejtë në trajtimin juridik dhe teknik të çështjeve të pronësisë, procedurave të regjistrimit dhe shqyrtimit administrativ të ankimeve.

Në vijim, në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës (ASHK) ka mbajtur funksione të rëndësishme drejtuese, përfshirë Përgjegjësin e Sektorit të Standardizimit të Shërbimeve të Kadastrës dhe Drejtorin e Drejtorisë Vendore ASHK Durrës.

Eksperienca e tij profesionale përfshin gjithashtu funksione drejtuese dhe menaxheriale në sektorin privat, përfshirë Illyrian Guard sh.a., si dhe angazhime në kërkimin e tregut, marketing, marrëdhëniet me klientët dhe veprimtarinë akademike. Gjatë karrierës së tij ka ushtruar gjithashtu funksionin e Kryeinspektorit pranë Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP).

Përvoja shumëvjeçare në pozicione profesionale dhe drejtuese i ka mundësuar të zhvillojë kompetenca në drejtimin dhe koordinimin institucional, menaxhimin e strukturave dhe ekipeve, analizën dhe zbatimin e legjislacionit, vendimmarrjen administrative, trajtimin e çështjeve të pronësisë, procedurat e apelimit administrativ, standardizimin e shërbimeve, monitorimin dhe kontrollin e proceseve dhe menaxhimin organizativ.

Profili i tij profesional karakterizohet nga ndërthurja e formimit juridik dhe social me përvojën konkrete drejtuese, menaxheriale dhe institucionale, të ndërtuar ndër vite në administratën publike dhe sektorin privat.

SEKSIONI PËR POLICINË, SHËRBIMIN SEKRET, BURGJET, FORCAT E ARMATOSURA DHE PUSHTETIN GJYQËSOR

Seksioni për Policinë, Shërbimin Sekret, Burgjet, Forcat e Armatosura dhe Pushtetin Gjyqësor (Seksioni i Veçantë) drejtohet nga Komisioneri dhe ka në përbërje katër ndihmëskomisionerë.

Komisioneri i Seksionit të Veçantë është zgjedhur nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë në përputhje me procedurat e parashikuara në nenin 33/1 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999, "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar.

Z. BESNIK DEDA
Komisioner i Seksionit të Veçantë

Z. Besnik Deda ushtron për një mandat 4-vjeçar funksionin e Komisionerit të Seksionit për Policinë, Shërbimin Sekret, Burgjet, Forcat e Armatosura dhe Pushtetin Gjyqësor në institucionin e Avokatit të Popullit, sipas Vendimit nr. 30/2024, miratuar më datë 04.04.2024 nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë Besnik Deda me detyrë Komisioner i Seksionit për Policinë, Shërbimin sekret, Burgjet, Forcat e Armatosura dhe Pushtetin gjyqësor, pranë Avokatit të Popullit, ka lindur në vitin 1965 në Vlorë. Ai ka kryer arsimin e mesëm dhe të lartë në Akademinë Ushtarake "Skënderbej", Tiranë, në vitin 1986, si dhe Fakultetin Juridik në Universitetin "Ismail Qemali", Vlorë, në vitin 2009. Gjithashtu, ai ka kryer edhe "Kolegjin e Lartë të Sigurisë" pranë Akademisë së Mbrojtjes në Tiranë, kolegj i njohur në nivel rajonal dhe i çertifikuar nga NATO. Gjatë karrierës së tij, ka kryer një sërë trajnimesh brenda dhe jashtë vendit, në fushat e pozicioneve si punonjës i nivelit të lartë në administratwn publike. Ka një eksperiencë mbi 30 vjet në funksione të ndryshme të FA, si dhe në administratën publike në nivel qëndror në Kuvendin e Shqipërisë, Ministrinë e Ekonomise, Ministrinë e Financave dhe në sektorë privat. Nga viti 2013 dhe në vijim, ai ka kryer detyra në funksione të ndryshme në institucionin e Avokatit të Popullit.

Z. KEID KALAJA
Ndihmëskomisioner në Seksionin e Veçantë

Z. Keid Kalaja aktualisht në pozicionin e Ndihmës Komisionerit në seksionin e Veçantë, ka studiuar në Fakultetin e Drejtësisë pranë Universitetit të Tiranës ku u diplomua në vitin 2020 në programin bachelor në drejtësi dhe në programin Master Shkencor Civil në vitin 2022. Gjithashtu ka ndjekur studimet ne Fakultetin e Leiden në Hollandë për Drejtësi Europiane. Në vitin 2023 ka fituar titullin Avokat pas përfundimit të Shkollës së Avokatisë të Shqipërisë. Z. Kalaja më parë ka mbajtur detyrën e specialistit në Drejtorinë Juridike, Sektori Gjyqësor në Bashkinë e Tiranës në periudhën 2021-2023, në të cilën ka bërë përfaqësimin e institucionit në proceset gjyqësore civile dhe administrative. Gjithashtu ka eksperiencë në sektorin privat ku ka mbajtur pozicionin e Kordinatorit për mardhëniet me partnerët e huaj në shoqëri sigurimesh, gjatë periudhës 2023-2024.

Z. ADIL SKUQI
Ndihmëskomisioner në Seksionin e Veçantë

Z. Adil Skuqi është pjesë e institucionit të Avokatit të Popullit prej vitit 2008. Aktualisht mban pozicionin Ndihmëskomisioner në Seksionin e Veçantë. Ai ka përfunduar Fakultetin e drejtësisë në Shkollën e Lartë Universitare Jopublike "Luarasi" në vitin 2008. Karrierën në Institucionin e Avokatit të Popullit e ka nisur në vitin 2008 ku fillimisht ka kryer detyrën e sekretarit të Seksionit të Përgjithshëm. Më pas është emëruar përgjegjës në Sektorin e Informacionit dhe Pritjes së Popullit. Në Qershor të vitit 2008 është emëruar ndihmëskomisioner në Mekanizimin Kombëtar të Parandalimit të Torturës. Pas rreth katër vitesh punë në MKPT është transferuar me detyrë pranë Seksionit të Veçantë, seksion që ndër të tjera shqyron edhe ankesa të të personave të privuar nga liria dhe personave të ndaluar/arrestuar nga Policia e Shtetit. Gjatë eksperiencës si pjesë e institucionit të Avokatit të Popullit është trajnuar vazhdimisht brenda dhe jashtë vendit për çështje të të drejtave të njeriut në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

ZNJ. FJONA ZAÇAJ
Ndihmëskomisionere në Seksionin e Veçantë

Znj. Fjona Zaçaj është pjesë e institucionit të Avokatit të Popullit prej vitit 2019. Aktualisht mban pozicionin Ndihmëskomisionere në Seksionin e Veçantë. Ajo ka përfunduar studimet në Fakultetin e Drejtësisë, Universiteti i Krajovës, Rumani, në vitin 2004. Në vitin 2008 përfundoi studimet master në Fakultetin e Drejtësisë në Tiranë. Në periudhën 2004 - 2007 ka punuar juriste pranë njësisë së qeverisjes vendore, Fondacionit të Biznesit të Vogël, si dhe eksperte e jashtme e Qendrës për Nisma Ligjore Falas. Gjatë viteve 2007-2009 ka ushtruar detyrën e specialistes në Drejtorinë Juridike të Ministrisë së Brendshme dhe më pas, 2009-2016 ka mbajtur postin e përgjegjëses së sektorit të akteve në këtë drejtori, ku ka ndjekur procedurat për hartimin dhe miratimin e

projektakteve ligjore dhe nënligjore, dhënien e asistencës dhe mendimit ligjor, përfaqësimin e ministrisë në grupe pune etj. Në periudhën 2016-2017 ka punuar si ndihmëskomisionere në Mekanizmin Kombëtar për Parandalimin e Torturës, pranë Avokatit të Popullit, me fokus inspektimin dhe vëzhgimin rregullisht të ambienteve ku mbahen personat e privuar nga liria. Gjatë vitit 2018 ka ushtruar detyrën e këshilltares ligjore në njësinë e shërbimit ligjor, në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit, me objekt studimin e dosjeve dhe përgatitjen e relacioneve në kuadër të procesit të rivlerësimit.

Ka marrë pjesë në trajnime e seminare të ndryshme profesionale, brenda dhe jashtë vendit.

ZNJ. EDLIRA CIMBI
Ndihmëskomisionere në Seksionin e Veçantë

Znj. Edlira Cimbi ushtron detyrën si Ndihmës Komisioner në Seksionin për Policinë, Shërbimin Sekret, Burgjet, Forcat e Armatosura dhe Pushtetin Gjyqësor pranë Institucionit të Avokatit të Popullit. Ajo ka kryer studimet në Fakultetin Juridik të Universistetit të Tiranës gjatë viteve 1992- 1996 dhe i ka përfunduar ato me rezultate të shkëlqyera. Në vitin 2006 ka marrë titullin "Avokat" dhe është anëtare e Dhomës së Avokatëve Tiranë.Më pas, për të rritur dhe pasuruar aftësitë profesionale në vitin 2013 ka studiuar dhe përfunduar ciklin e studimeve Master Shkencor në fushën e Administrim Biznesit pranë Universitetin "S&P Qiriazi" Tiranë. Znj. Edlira Cimbi ka një eksperiencë të gjatë pune si juriste, duke filluar që nga viti 1997 e në vazhdim si në sektorin privat, kryesisht në shoqëritë aksionere të sektorëve strategjik si Albtelecom sha në sektorin e telekomunikacionit dhe më pas ARMO

sha në sektorin e hidrokarbureve ashtu dhe në administratën publike. Gjatë eksperiencave të punës është specializuar kryesisht në fushën civile, tregtare dhe administrative duke ushtruar dhe profesionin e avokatit me përfaqësimet në të gjitha shkallët e gjyqësorit për çështje të ndryshme. Eksperienca e saj në sektorin publik ka vazhduar në vitin 2015 si Drejtore e Administrimit të Brendshëm në Agjencinë e
Ofrimit të Shërbimeve Pulike të Integruara (ADISA), ku në këtë pozicion drejtonte Sektorin Ligjor, Trajnimin, Burimet Njerëzore dhe Shërbimet Mbështetëse. Gjatë kësaj periudhe ka dhënë kontributin e saj aktiv në zbatimin e reformës në administratën publike, konkretisht në reformimin e ofrimit të shërbimeve publike në vend si dhe në hartimin dhe harmonizimin e legjislacionit në këtë fushë. Pjesmarrëse aktive në grupe pune ndërinstitucionale si dhe në komitete drejtues me fokus strategjitë ndërsektoriale në përmirësimin e punës së administratës publike në vend. Në fillim të vitit 2019, me krijimin e Institucioneve te reja të drejtësisë në kuadër të Reformës në Drejtësi, ka punuar pranë Këshilli i Lartë i Prokurorisë (KLP) fillimisht në pozicionin e Drejtorit të Kabinetit të Kryetarit të Këshillit e më pas si Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Ligjore. Gjatë eksperiencës në KLP është angazhuar në hartimin e akteve nënligjore si dhe në dhënien e opinioneve ligjore për procedurat administrativo-ligjore që ndiqeshin nga komisionet e përhershme apo të përkohëshme të KLP-së.

MEKANIZMI KOMBËTAR PËR PARANDALIMIN E TORTURËS, TRAJTIMIT OSE DËNIMIT TË EGËR, ÇNJERËZOR OSE POSHTËRUES

Mekanizmi kombëtar për Parandalimin e Torturës, Trajtimit ose Dënimit të Egër, Çnjerëzor ose Poshtërues (MKPT) drejtohet nga Komisioneri dhe ka në përbërje katër ndihmëskomisionerë.

Komisioneri i MKPT është zgjedhur nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë në përputhje me procedurat e parashikuara në nenin 33/1 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999, "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar.

Z. AHMET PRENCI
Komisioner i Mekanizmit kombëtar për Parandalimin e Torturës, Trajtimit ose Dënimit të Egër, Çnjerëzor ose Poshtërues

Z. Ahmet Prençi, ushtron për një mandat 4-vjeçar funksionin si Komisioner i Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës, trajtimit ose dënimit të egër, çnjerzor ose poshtrues pranë Avokatit të Popullit që nga data 26 Prill 2022 sipas vendimit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë Ahmet Prençi është diplomuar Jurist në Universitetin e Tiranës dhe ekonomist në Universitetin Bujqësor Tiranë. Ka kryer studime të avancuara pasuniversitare jashtë vendit në fushën e të drejtës dhe sigurisë. Mban titullin "Avokat". Ka një karrier të pasur 30 – vjeçare, kryesisht në institucionet ligjzbatuese të shtetit shqiptarë si dhe në mësimdhënie dhe shoqërinë civile.
Në vitin 1992 ka nisur karrierën si hetues dhe officer i policisë gjyqësore në Prokurorinë Krujë e më pas në Prokurorinë e Tiranës deri në vitin 2000 ku kryesisht është marrë me hetimin e veprave të ndryshme penale. Nga viti 2000 deri në vitin 2010 ka kryer detyra në funksione drejtuese në Policinë e Shtetit në disa rrethe si dhe Drejtor i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit. Pas largimit nga kjo detyrë ka punuar si këshilluar i Ministrit të Brendshëm, Drejtor i Hetimit Tatimore, Inspektor i Lartë në Inspektoriatin e Deklarimit, Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të interest për Zyrtarët e Lartë. Pas vitit 2018, është marrë me mësimdhënie në Universitete private si lektor i Kriminalistikës, Kriminologjisë dhe të Drejtës Penale si dhe me angazhme në këshillime e konsulenca juridike, menaxhim projekti dhe aktivizëm në shoqërinë civile si ekspert në fushën e drejtësisë dhe të drejtave të njeriut deri në vitin 2022. Gjithashtu, Ahmet Prençi ka qenë prezent vazhdimisht në media kombëtare e ndërkombëtare me intervista, analiza dhe opinine që lidhen me fushën e sigurisë, drejtësisë dhe të drejtat e njeriut. Ai është autor i

disa librave artistik me poezi, ese dhe romane ku ka fituar disa çmime kombëtare dhe librat e tij janë përkthyer e botuar edhe jashtë vendit.

ZNJ. NERTILA ISMAJLGECI
Ndihmëskomisionere pranë MKPT

Znj. Nertila Ismajlgeci është pjesë e institucionit të Avokatit të Popullit prej vitit 2018. Aktualisht mban pozicionin Ndihmëskomisionere pranë Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës, Trajtimit ose Dënimit të Egër, Çnjerëzor ose Poshtërues, me statusin e nëpunësit civil të nivelit të lartë drejtues. Ajo është diplomuar në Fakultetin e Shkencave Sociale në vitin 2008 në Degën Psikologji me Titullin Psikolog Klinicist. Për një periudhë 1 vjeçare ka punuar si Përgjegjëse e Burimeve Njerëzore pranë Kompanie Private. Prej vitit 2009 deri vitin 2013 ka punuar pranë Shërbimit Kombëtar të Punësimit në pozicione të ndryshme si Specialiste dhe Përgjegjëse Sektori. Prej vitit 2014 deri në vitin 2018 ka qënë kryetare e Shoqatës për mbrojtjen e të larguarve nga Administrata, pjesë e shoqërisë civile. Gjatë eksperiencës si pjesë e institucionit të Avokatit të Popullit është trajnuar vazhdimisht brenda dhe jashtë vendit për çështje të të drejtave të njeriut në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

Z. HAZBI SELITA
Ndihmëskomisioner pranë MKPT

Z.Hazbi Selita është pjesë e institucionit të Avokatit të Popullit prej vitit 2020. Aktualisht mban pozicionin Ndihmëskomisionere pranë Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës, Trajtimit ose Dënimit të Egër, Çnjerëzor ose Poshtërues. Ai ka përfunduar studimet në Fakultetin Juridik të Universitetit të Tiranës në vitin 2011 si Jurist- Specializuar në "e Drejtë Penale". Në periudhën 2012 deri 2016, ka ushtruar detyrën e Specialistit në Drejtorinë e Pergjithshme të Sherbimit të Provës, Zyra Vendore Tiranë. Nga viti 2016 deri në vitin 2019 ka punuar pranë Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, në pozicione të ndryshme si Këshilltar dhe Ndihmës – inspektor. Për periudhën Qershor 2019 deri në Janar 2020 ka punuar si ekspert i jashtëm në Institucionin e Avokatit të Popullit me aktivitet dhe pergjegjesite kryesore Iinspektime në institucionet e privimit të lirise për të Miturit në Konflikt me Ligjin".

ZNJ. GLORIA ÇARKAXHIU
Ndihmëskomisionere pranë MKPT

Znj. Gloria Çarkaxhiu është pjesë e institucionit të Avokatit të Popullit prej vitit 2020. Aktualisht mban pozicionin Ndihmëskomisionere pranë Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës, Trajtimit ose Dënimit të Egër, Çnjerëzor ose Poshtërues. Ajo ka përfunduar studimet e larta për Juridik në Fakultetin e Shkencave Juridike, Ekonomike dhe Politike të Universitetit Aristoteli të Selanikut në Greqi ekuivalentuar Master Shkencor. Ka një eksperiencë mbi 10 vjeçare në profesionin e juristit. Pas përfundimit të studimeve për një vit ka punuar si asistentavokate dhe në vitin 2012 ka marrë titullin "Avokat" nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë. Prej vitit 2012 deri në vitin 2020 ka punuar si eksperte në Drejtorinë e Përgjithshme të Kodifikimit dhe Harmonizmit të Legjislacionit në Ministrinë e Drejtësisë dhe më pas ka qënë Përgjegjëse e Sektorit të Diasporës, pranë Agjencisë Kombëtare të Diasporës. Ka marrë pjesë në shumë trajnime të zhvilluara si brenda dhe jashtë vendit për hartimin e legjislacionit, për procesin legjislativ shqiptar dhe implementimin e legjislacionit me acquis communautaire, për parandalimin dhe adresimin e dhunës seksuale dhe të bazuar në gjini në institucionet e mbyllura, për forcimin e Antikorrupsionit në Evropën Juglindore përmes Përmirësimit të Masave të Konfiskimit të Pasurive etj. Ka qenë eksperte në grupet e punës të ngritura nga Ministri i Drejtësisë kryesisht për analizimin dhe hartimin e legjislacionit përgjatë reformës në drejtësi dhe akteve nënligjore në zbatim të saj, paketës penitenciare etj. Ka qenë pjesë e

grupit të ekspertëve në Komitetin për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimin e Terrorizmit (Moneyval) të Këshillit të Evropës, përfaqësuese në Grupin e Punës për Vlerësimin Universal Periodik (UPR) të Shqipërisë në Kombet e Bashkuara etj.

Z. VULLNET TOPALLI
Ndihmëskomisioner pranë MKPT

Z. Vullnet Topalli është pjesë e institucionit të Avokatit të Popullit prej muajit prill të vitit 2025.
Aktualisht mban pozicionin Ndihmëskomisioner pranë Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës, Trajtimit ose Dënimit të Egër, Çnjerëzor ose Poshtërues.
Ai ka përfunduar studimet në Akademinë Ushtarake në Tiranë në vitin 1994. Në vitin 2004 ka përfunduar Akademinë e Rendit Publik. Në vitin 2011 ka perfunduar masterin në Studime mbi Sigurinë Kombëtare në ALBANIAN UNIVERSITY. Në vitin 2015 ka perfunduar Fakultetin Juridik në Universitetin e Tiranës - Specializuar në "e Drejtë Civile". Në periudhën 1994 deri 1997 ka ushtruar detyrën e komandantit të togës dhe zv/ komandantit te kompanisë në Gardën e Republikës, prill-dhjetor 1997 komandat toge në repartin special "Brisku" në Policinë e Shtetit. Janar-Qershor 1998 komandant poste në policinë kufitare në komisariatin e policisë Malësi e Madhe. Qershor 1998-2013 në repartin special "Brisku" me detyra komanduese e drejtuese. 2003-2005 komandanti repartit forcave te ndërhyrjes së shpejtë (FNSH) 711 në Tiranë. 2005-2007 zv-komandant i repartit forcave të ndërhyrjes së shpejtë në Tiranë . Janar-dhjetor 2007 Komandant i repartit special "Brisku". Janar-shtator 2008 shef komisariati policisë Sarandë. Në vitet 2008-2010 Drejtor i Policisë Qarkut Shkodër. Nga 2010-2012 Drejtori Përgjithshëm i Policisë Rrugore në policinë shtetit. Nga 2012-2015 drejtor i policisë bashkiake në Bashkinë Tiranë. Nga 2015 deri në 2025 në biznes privat.

SEKSIONI I PËRGJITHSHËM

Seksioni i Përgjithshëm drejtohet nga Komisioneri dhe ka në përbërje katër ndihmëskomisionerë.

Komisioneri i Seksionit të Përgjithshëm është zgjedhur nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë në përputhje me procedurat e parashikuara në nenin 33/1 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999, "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar.

ZNJ. VILMA SHURDHA
Komisionere e Seksionit të Përgjithshëm

Znj. Vilma Shurdha ushtron për një mandat të dytë 4-vjeçar funksionin e Komisionerit të Seksionit të Përgjithshëm të sipas Vendimit nr. 32/2024, miratuar më datë 04.04.2024 nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, me fokus mbrojtjen dhe parandalimin e të drejtave të njeriut, veçanërisht grupet vulnerabël, personat me aftësi të kufizuara, minoritetet. gratë, grupet e pafavorizuara etj Vilma Shurdha, mban titullin "Jurist", diplomuar nga Universiteti i Tiranës, Fakulteti Juridik, si dhe titullin "Avokat". Ajo ka një karrierë të pasur dhe të diversifikuar në fushën e drejtësisë, këshillimit juridik dhe të drejtave themelore. Fillimisht, pas diplomimit në vitin 1998, ajo nisi karrierën e saj në sektorin publik, e angazhuar në përfaqësimin e institucionit në projekte dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, duke hartuar dhe rishikuar akte ligjore në fushat e kulturës, turizmit dhe sporteve. Pas kësaj periudhe, ajo kaloi në sektorin privat, duke punuar si avokate në disa zyra avokatieku ka ofruar konsulencë ligjore dhe ka menaxhuar projekte në fusha të ndryshme, duke përfshirë energjinë, industrinë minerare, të drejtën bankare, projekte të sektorit publik, mbrojtjen sociale, prokurimin publik dhe të drejtën tregtare. Në periudhën

2007-2013 u rikthye në administratën publike, në Agjencinë e Trajtimit të Koncesioneve, detyrë në të cilën ka ofruar asistencë ligjore për procedurat e koncesioneve dhe ka kryer negocimet për kontratat e koncesioneve me ofruesit fitues. Në periudhën 2013-2018 iu rikthye profesionit të avokatisë. Në vitin 2018, ajo mori detyrën e Këshilltares Juridike të Ministrit në Ministrinë e Financës dhe Ekonomisë, duke ofruar konsulencë ligjore për çështje të ndryshme të kompetencës së Ministrisë. Në vitin 2019, me vendimin nr.38/2019 të Kuvendit të Shqipërisë, Vilma Shurdha mori detyrën e Komisioneres në Seksionin e Përgjithshëm.

ZNJ. MIMOZA MORINA
Ndihmëskomisionere në Seksionin e Përgjithshëm

Znj.Mimoza Morina është pjesë e institucionit të Avokatit të Popullit prej vitit 2006. Aktualisht mban pozicionin Ndihmëskomisionere në Seksionin e Përgjithshëm, me statusin e nëpunësit civil të nivelit të lartë drejtues. Ajo ka përfunduar studimet e larta në Fakultetin e Shkencave Politike, Dega Filozofi në vitin 1988 dhe Fakultetin Juridik, Universiteti Tiranë në vitin 2001. Më datë 20.03.2004 ka fituar titullin "Avokat". Për periudhën Prill 1989-Korrik 1996 ka punuar si specialiste për nxjerrjen e të dhënave statistikore në Prokurorinë e Rrethit Tiranë. Për periudhën Gusht 1996Dhjetor 2005 ka punuar pranë Shërbimit Social Shtetëror si Specialiste në Sektorin e Marrëdhenieve me Publikun; Inspektore e Ndihmës Ekonomike dhe Juriste në Sektorin e Aftësisë së Kufizuar. Gjatë eksperiencës si pjesë e institucionit të Avokatit të Popullit është trajnuar vazhdimisht brenda dhe jashtë vendit për çështje të të drejtave të njeriut në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

ZNJ. LINDITA XHILLARI
Ndihmëskomisionere në Seksionin e Përgjithshëm

Znj. Lindita Xhillari është pjesë e institucionit të Avokatit të Popullit prej vitit 2008. Aktualisht mban pozicionin Ndihmëskomisionere në Seksionin e Përgjithshëm, me statusin e nëpunësit civil të nivelit të lartë drejtues. Ajo ka mbaruar studimet ne Fakultetin e Drejtesise, Universiteti i Tiranes ne vitin 1996. Ka mbaruar masterin shkencor ne katedren civile ne Fakultetin e Drejtesise ne vitet 2003-2005. Me tej ne vitet 2013-2019 ka kryer studimet e thelluara doktorale prane Universitetit te Tiranes, Fakultetit te Drejtesise, Katedres Publike dhe ka fituar graden "Doktor i Shkencave". Per 2 vjet ka punuar si koordinatore ne Shoqaten e Atlantikut te Veriut, organizate e shoqerise civile. Me pas per periudhen 1998-2002 ka punuar si juriste ne Ministrine e Shendetesise, e me tej si specialiste prokurimi ne strukturat e varesise se kesaj ministrie. Ne vitet 2002 deri ne 2007 ka mbajtur pozicionin e Drejtores se Zyres Juridike prane Presidentit te Republikes se Shqiperise. Ne vitin 2007-2008 ka punuar si Drejtore Juridike ne Dhomen e Tregtise dhe Industrise, Tirane. Per periudhen 1996-2005 ka qene pedagoge e jashtme ne Fakultetin e Drejtesise, katedra Civile, lenda ""E drejte Biznesi"", ne Fakultetin Ekonomik.

ZNJ. DEJANA BURGIJA
Ndihmëskomisionere në Seksionin e Përgjithshëm

Znj. Dejana Burgija është pjesë e institucionit të Avokatit të Popullit prej vitit 2017, fillimisht si anëtare e kabinetit e më pas ka mbajtur pozicionin si drejtore e Drejtorisë së Financës, Shërbimeve dhe Pritjes së Qytetarëve. Nga viti 2022 e në vazhdim mban pozicionin ndihmëskomisionere në Seksionin e Përgjithshëm.
Ajo ka përfunduar studimet universitare në Fakultetin Ekonomik pranë Universitetit të Tiranës, duke marrë titullin

“financiere” në vitin 2004. Në vitin 2012 ka përfunduar ciklin e studimeve pasuniversitare profesionale intensive EuroMediterranean Studies pranë University EMUNI, Portoroz, Slovenia. Në vitin 2013 ka përfunduar studimet pasuniversitare në Fakultetin Ekonomik pranë Universitetit të Tiranës në degën Menaxhim Biznesi (Sipërmarrje). Ka studiuar pranë Akademisë Diplomatike Shqiptare, Qendra për Marrëdhënie Nderkombetare dhe Diplomaci, në fushën Marredhënie Ndërkombëtare dhe Diplomaci. Pas përfundimit të studimeve universitare, znj. Burgija ka punuar për periudhën 2004-2009 në sektorin bankar, si financiere e më pas si drejtuese e njërës prej agjencive të Bankës Kombëtare Greke. Prej vitit 2009 deri në vitin 2013 ka drejtuar Drejtorinë Rajonale të Punësimit Durrës.
Për periudhën 2013-2017 ka punuar financiere në biznes privat dhe njëkohësisht si lektore pranë Departamentit Financë-Kontabilitet në Fakultetin Ekonomik të Universitetit Aleksandër Moisiu, Durrës, për lëndët “Paraja dhe banka” dhe “Sistemet Financiare në BE”. Znj. Burgija është trajnuar në fusha të ndryshme si menaxhimi i migracionit me qëllim punësimin në Ballkanin perëndimor, ngritje e kapaciteteve të komiteteve rajonale për luftën kundër trafikimit të qënieve njerëzore, për politikat dhe legjislacionin lidhur me personat me aftësi të kufizuar, për përfshirjen gjinore dhe forcimin e mekanizmave shtetërore për barazinë gjinore në Shqipëri, për përqasjen e sektorit publik dhe planifikimin strategjik, ka ndjekur trajnimin e parë për ndermjetësues, trajnime për të drejtat e njeriut, etj.

ZNJ. BRISIDA KERTUSHA
Ndihmëskomisionere në Seksionin e Përgjithshëm

Znj. Brisida Kërtusha është pjesë e institucionit të Avokatit të Popullit prej vitit 2019. Aktualisht, mban pozicionin Ndihmëskomisionere në Seksionin e Përgjithshëm. Ajo ka ka kryer studimet në Fakultetin e Shkencave Sociale të Universitetit të Tiranës përgjatë viteve 2001-2005. Më tej, ka përfunduar Masterin e shkencave për Politika dhe Qeverisje në Europë, në Institutin e Studimeve Evropiane, Universiteti i Tiranës. Ajo ka një eksperiencë disa vjeçare në institucione të ndryshme të administratës shtetërore. Gjatë periudhës 2005-2009 ka punuar në Institucionin e Prefektit Qarku Durrës specialist për çështjet sociale. Gjatë viteve 2009-2013 ka ushtruar detyrën e Drejtorit, pranë Drejtorisë së Politikave Rinore në Ministrinë e Turizmit Kulturës Rinisë dhe Sporteve, kontributi i dhënë në këtë sektor konsistonte në planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e projekteve rinore dhe dokumentave strategjikë. Në kuadër të ristrukturimit të fushave të përgjegjësive të ministrive të linjës, gjatë periudhës 2013-2019, ka ushtruar detyrën si eksperte e politika rinore në Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë dhë në Ministrinë e Arsimi Sportit dhe Rinisë në të cilën kontributi i saj ka konsistuar në hartimin dhe zbatimin e Planit Kombëtar të Veprimit për Rininë 2015-2020 në harimin e projekt Ligjit për Rininë, hartimin e akteve të tjera ligjore dhe nënligjore si edhe si edhe koordinimin e programave të ndryshme për të rinjtë. Përgjatë viteve 2020-2021 ka punuar si ekpserte në Seksionin për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve në Avokatin e Popullit, ku është angazhuar në monitorimit e kushteve dhe drejtave të fëmijëve të privuar nga liria, apo në konflikt me ligjin. Nga periudha 2021-2022 ka ushtruar detyrën si Përgjegjëse në Sektorin e Bashkëpunimit Ndërkombëtar dhe Integrimit Evropian pranë Avokatit të Popullit, ku ndër të tjera është trajnuar brenda dhe jashtë vendit për çështje të të drejtave të njeriut në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Në vitin 2022, znj. Brisida Kërtusha është emëruar ndihmëskomisioner në Seksionin e Përgjithshëm, në institucionit të Avokatit të Popullit.

ZNJ. BRUNILDA DERVISHAJ
Ndihmëskomisionere në Seksionin e Përgjithshëm

Znj. Brunilda Dervishaj, është pjesë e Avokatit të Popullit prej vitit 2022. Aktualisht, mban pozicionin e ndihmëskomisioneres në Seksionin e Përgjithshëm, me statusin e nëpunësit civil të nivelit të mesëm drejtues. Ka ndjekur studimet e larta në Fakultetin e Drejtësisë, Universiteti i Tiranës, duke marrë titullin "Jurist" në vitin 1995. Prej vitit 1998- 2022 ka punuar si specialiste dhe drejtuese e strukturave shtetërore për çështjet e barazisë gjinore, kundër dhunës ndaj grave dhe mbrojtjes nga diskriminimi për grupet e disavantazhuara. Gjatë kësaj periudhe është kualifikuar si eksperte e barazisë gjinore dhe të drejtave të grave, si brenda dhe jashtë vendit, duke qenë dhe Trajnere për këto çështje. Gjatë kësaj periudhe ka qenë pjesë e grupeve ndërinsitucionale, që kanë punuar për përmirësimin e legjislacionit dhe hartimit të politikave për barazinë gjinore, pjesë e shkrimit të raporteve kombëtare për zbatimin e Konventava për të Drejtat e Njeriut si: "Konventa për eleminimint e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj grave", Konventa e Këshillit të Evropës "Për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje" si dhe pjesë e delegacioneve për mbrojtjen e këtyre raporteve. Përfaqësuese e shtetit në Komitetin për Barazi Gjinore të Këshillit të Evropës prej 2019-2022. Përfaqësuese e shtetit për barazinë gjinore, kundër dhunës ndaj grave dhe mbrojtjes nga diskriminimi për LGBT, në negociatat me Bashkimin Evropian.
Pjesmarrëse dhe lektore në Konferenca Kombëtare dhe Ndërkombëtare lidhur me të drejtat e njeriut.

DREJTORIA E FINANCËS, SHËRBIMEVE DHE PRITJES SË QYTETARËVE

ZNJ. AIDA ISAJ
Drejtoreshë e Drejtorisë së Financave dhe Pritjes së Qytetarëve

Znj. Aida Isaj është diplomuar në Financë pranë Fakultetit të Ekonomisë, Universiteti i Tiranës. Ka një përvojë të gjatë profesionale në sektorin bankar, ku ka ushtruar funksione të ndryshme drejtuese dhe menaxheriale, përfshirë pozicionin e Drejtores së Degës në Alpha Bank Elbasan.

Prej vitit 2023 është pjesë e institucionit të Avokatit të Popullit, ku ka ushtruar funksionet e Drejtorit të Kabinetit dhe Përgjegjëses së Burimeve Njerëzore. Që nga marsi 2024 ushtron detyrën e Drejtorit të Drejtorisë së Financës, Shërbimeve dhe Pritjes së Qytetarëve.

Në këtë funksion, ajo përgjigjet për organizimin dhe drejtimin e veprimtarisë së drejtorisë, menaxhimin e burimeve financiare, ekonomike dhe njerëzore, si dhe koordinimin e shërbimeve administrative dhe mbështetëse të institucionit.